

VENDIM
Nr.511, datë 2.12.1992

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET MINISTRISË SË NDËRTIMIT, TË
STREHIMIT DHE RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE MINISTRISË SË NDËRTIMEVE PUBLIKE DHE RREGULLIMIT TË TERRITORIT
TË REPUBLIKËS SË RUMANISË**

Në mbështetje të nenit 36, pika 6 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e "Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Ndërtimeve Publike dhe Rregullimit të Territorit të Republikës së Rumanisë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi